

P.nr.247/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM NË PRISHTINË, gjyqtari i vetëm gjykues Naser Foniqi, me procesmbajtësen Sevdije Breznica, në çështjen penale të të pandehurit Sh.D, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 8, lidhur të KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.5313/2013, të datës 31.01.2014, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur me datë 03.02.2017, në të cilin ishin të pranishëm: Prokurori i Shtetit Merita Shala-Muhaxhiri; i pandehuri Sh.D, me datë 03.02.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari Sh.D, i biri i H dhe Z, e vajzërisë A, i lindur me *data e lindjes*, në P, tani me vendbanim në fshatin O, Komuna P, numër .., me *numër personal*, i martuar-baba i një fëmije, ka të kryer fakultetin ekonomik, i punësuar – realizon pagë mujore prej 620 euro, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

S e p s e: me datë 26.07.2013, rreth orës 11:20, në Prishtinë, në rr. “Bill Clinton” nga rrethi i madh në drejtim të qytetit, te semaforët në lagjen Dardania, derisa ka qenë duke lëvizur me automjetin e tij të tipit “V G”, ngjyrë e kaltër, me targa...-...-..., nga pakujdesia, duke menduar se deri te aksidenti nuk do të vij, ka rrezikuar komunikacionin dhe ka vënë në rrezik jetën dhe trupin e njerëzve, në kundërshtim me nenin 150.3 të LSKRR, nuk ka përshtatur mënyrën e lëvizjes kushteve dhe rrethanave të krijuara në rrugë, ashtu që, nuk i ka kushtuar kujdesin e duhur këmbësorëve, përkatësisht tani të dëmtuarës – këmbësorës D.M –A, e cila në momentin kritik ka qenë duke kaluar rrugën nga ana e djathtë në të majtë, shikuar drejtimin e lëvizjes, në vendin ku ekziston vendkalimi për këmbësor, e ç’rast, i pandehuri të njëjtën e ka goditur me pjesën e përparme të anës së djathtë të automjetit të tij, e si pasojë e këtij aksidenti e dëmtuara D ka pësuar lëndime të rënda trupore, përkatësisht thyerje e kockave metatarsale të gishtave 2 e 3 të këmbës së majtë, ndrydhje e qafës, regjionit të supit të majtë dhe gjurit të majtë,-

-me këtë, ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 8 të KPRK.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 45; 47; 73 dhe 378, par. 8 të KPRK, si dhe nenit 365, të KPPK, i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

- Në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj.
- Në bazë të nenit 38 par.3 të Kodit Penal të Kosovës, me pëlqimin e të pandehurit Sh.D, dënimi me burgim i zëvendësohet në dënim me gjobë **në shumë prej një mijë e dy qind (1200) €**, të cilën gjobë, i pandehuri obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

- Dënimin me gjobë, si më lart, i pandehuri mund ta paguaj me këste.
- Obligohet i akuzuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale, ashtu që: për ekspertizën mjeko ligjore të paguaj shumën **20.00 €**, për ekspertizën e komunikacionit të paguaj shumën **40.88 €**, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **40 €**, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- **E dëmtuara D.M-A**, nga F K, lagjja A, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A R S Y E T I M I

Pas paraqitjes së kallëzimit penal të Policisë së Kosovës, Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor në Prishtinë, nr.2013-AR-2131, të datës 02.08.2013, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.5313/2013, të datës 31.01.2014, ka akuzuar të pandehurin Sh.D, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 8 të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të datës 03.02.2017, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i pandehuri Sh.D, ka deklaruar se e ka kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë, pastaj atij i është ofruar mundësia të pranoj fajësinë ose të deklarohej i pa fajshëm, ashtu që i pandehuri është deklaruar fajtorë dhe ka shtuar se këtë vepër penale nuk e ka kryer me qëllim, se pas aksidentit të dëmtuarën e ka futur në veturën e tij dhe e ka dërguar në emergjencë, si dhe ka qëndruar aty derisa e njëjta është ekzaminuar dhe ka kryer fotografimet e nevojshme, pastaj të nesërmen pas aksidentit prapë e ka vizituar të dëmtuarën, të njëjtën e ka telefonuar për një kohë të gjatë rreth 6 muaj pas aksidentit, për tu interesuar për shëndetin e saj. Po ashtu, i pandehuri ka thënë se i vjen shumë keq që ka ndodh ky rast, bile ka theksuar se ashtu si është ndierë në kohën kur ka ndodhur aksidenti ndihet edhe tani, se familja e tij i ka kërkuar falje të dëmtuarës dhe familja e saj e ka pranuar ndjesën e shprehur. Në fund të fjalës së tij, i pandehuri ka theksuar se kërkon nga gjykata që nëse e shpall fajtorë, atij t'i shqiptoi një dënim më të vogël, duke pasur parasysh se është i punësuar dhe nga puna e tij varet ekzistenca e familjes së tij, pasi që është i vetmi që punon në familje dhe që siguron të ardhura për mirëqenien e familjes.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri, Prokurori i Shtetit, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, meqenëse ky pranim është bërë konform dispozitave të nenit 248, të KPPK, duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe me rastin e matjes së dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese, përkatësisht pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale.

Pas deklarimit të pandehurit se ndihet fajtorë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri Sh.D, pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht dhe i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës, por edhe nga deklaratimet e palëve në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit Sh.D, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 8 të KPRK, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtorë të pandehurin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë; sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit fillestar, si dhe sjelljen e tij para dhe pas kryerjes së veprës penale, pasi që për të pandehurin në të dhënat e kësaj gjykate nuk rezultoi të jetë hapur ndonjë rast tjetër penal; ndërsa si rrethanë rënduese, gjykata mori intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur pasi që e dëmtuara është aksidentuar në vendkalimin për këmbësorë, prandaj, gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK.

Pas shpalljes së aktgjykimit, i akuzuari është deklaruar se e pranon dënimin e shqiptuar dhe ka dhënë pëlqimin që ky dënim t'i zëvendësohet me dënim me gjobë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1 dhe 2, të KPPK.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPK, pala e dëmtuar, është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga arsyet e cekura më lart dhe në kuptim të nenit 365, të KPPK është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 07.02.2017.

GJYKATA THEMELORE/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM NË PRISHTINË
P.nr.247/14, datë 03.02.2017.

Procesmbajtëse,
Sevdije Breznica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.